



SHËRBIMET SPECIFIKE QË MUND TË PËRFITOHEN NË KUADËR TË INICIATIVËS PËR FUQIZIM DIGJITAL

Marketingu Digjital

Menaxhim dhe Marketing të mediave sociale, optimizim i platformave të kërkimit (SEO), zhvillim i webfaqes dhe ndërlidhje me rrjete sociale, gjenerim dhe optimizim të përmbajtjes, email marketing, xhirim të videove promovuese dhe fotografive të produkteve për qëllime promovuese në media dhe rrjete sociale.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Kalkulim i saktë i pagave dhe regjistër automatik i pagave, automatizim i kërkesave për pushim vjetor dhe benefiteve tjera të punëtorëve, automatizim i të dhënave të punëtorëve dhe ndërlidhja e tyre me performancë individuale.

Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM)

CRM ndihmon ndërmarrjet për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me konsumatorët, duke ofruar pasqyrë reale mbi konsumatorët aktual. Ofron qasje më të lehtë në informacionet rreth konsumatorëve, siç janë të dhënat e kontaktit, blerjet e kaluara, preferencat e tyre, dhe sjellja e konsumatorit në përgjithësi. Ofron mundësi të komunikimit direkt me konsumatorin dhe analiza të ndryshme të të dhënave të tyre, duke ndihmuar në vendimmarrje rreth produkteve të reja, çmimeve dhe kanaleve të shitjes.

Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes (ERP)

Menaxhim i aktiviteteve të përditshme të biznesit, të tilla si kontabiliteti, prokurimi, menaxhimi i projekteve, menaxhimi i rrezikut dhe operacionet e zinxhirit të furnizimit. Digjitalizimi i ERP gjithashtu përfshin menaxhim të performancës së ndërmarrjes: planifikimin, buxhetimin, parashikimin dhe raportimin mbi rezultatet financiare.

E-commerce/ Tregtia – Platforma të shitjes online

Shitja e produkteve dhe shërbimeve në internet, menaxhimi i porosive, i inventarit dhe shërbimi ndaj klientit, faturimi dhe pagesat online, menaxhimi i faqes në internet, menaxhimi i marketingut etj.

Programe të ndryshme të automatizimit dhe të optimizimit të proceseve të ndryshme

Përveç shërbimeve të specifikuara më lart, Iniciativa për Fuqizim Digjital mund të ofroj edhe programe të ndryshme që janë specifike për ndërmarrje të caktuara. Këtu nënkuptohet zgjidhje të ndryshme softuerike që ndikojnë në përmirësimin e proceseve të brendshme dhe automatizim të ndërmarrjes.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT/KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar online kliko këtu: ekosova.rks-gov.net/504

Thirrja për aplikim është e hapur prej datës 27.03.2024 deri 19.04.2024.